



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.158 dt.29.09.1997

**PER  
PAGESEN E SIGURIMEVE SHOQËRORE PER PUNONJESIT E  
NDERMARRJES SE GALANTERISE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.09.1997, mori në shqyrtim relacionin “Mbi pagesën e Sigurimeve Shoqërore për punonjësit e Ndërmarrjes së Galanterisë”, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës. Këshilli Bashkiak mbështetur në ligjin “Për organizimin e Pushtetit lokal” Nr.7592, dt.10.06.1992 duke zbatuar ligjin Nr.7703, dt.02.05.1993, nenet.15, 16 për kontributet e sigurimeve shoqërore

**VENDOSI**

1. Të çelet një fond page 173.959 lekë, pagesë për sigurimet shoqërore për punonjësit e Ndërmarrjes së Galanterisë për periudhën 1 shkurt 1995 deri me 20 shtator 1996.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik (Sektori i Zhvillimit të Industrisë).
3. Ky vendim hyn në fuqi që nga data e marrjes së vendimit.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

